



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 00.5.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR
KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA
BERAT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 20.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar Bashkie dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Berat, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 2 (dy) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 65 dhe ZAZ nr. 66.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Berat.

Data: . .2023 Nr: 00
Ora:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Berat, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

KZAZ nr. 65 dhe KZAZ nr. 66 kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Berat dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Berat, u kontrolluan Tabelat Përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr. 65 dhe ZAZ nr. 66, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu edhe për këshillin, përfshijnë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve çdo QV-je të zonës zgjedhore.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Berat, Qarku Berat, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Berat sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të z. Ervin Demo si Kryetar i Bashkisë Berat, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Berat, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: . .2023 Nr:
Ora:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Berat, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 mai 2023”



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

BASHKIA BERAT, QARKU BERAT

Lidhja 1



		ZAZ 65	ZAZ 66	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	52.573	28.505	81.078
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	17.596	10.500	28.096
3	Vota të pavlefshme	658	379	1.037
4	Vota të vlefshme	16.915	10.101	27.016
5	Fletë votimi të hedhura gabim	23	20	43
1	Zija Fuat Ismaili	6.669	3.743	10.412
2	Ervin Zehni Demo	10.246	6.358	16.604
	Totali i votave të vlefshme	16.915	10.101	27.016



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

BASHKIA BERAT, QARKU BERAT

Lidhja 2



		ZAZ 65	ZAZ 66	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	52.573	28.505	81.078
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	17.590	10.501	28.091
3	Vota të pavlefshme	815	474	1.289
4	Vota të vlefshme	16.755	10.005	26.760
5	Fletë votimi të hedhura gabim	20	22	42
1	Bashkë Fitojmë	3.942	1.988	5930
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	9.219	5.862	15081
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	293	230	523
4	Partia Republikane Shqiptare	208	96	304
5	Partia Levizja e Legalitetit	172	71	243
6	Partia Demokracia Sociale	266	102	368
8	Partia Socialdemokrate	386	166	552
9	Partia Demokratike	1.564	1.191	2755
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	146	50	196
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	559	249	808
	Totali i votave të vlefshme	16.755	10.005	26.760